



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 27.12.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.12.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Laguna SHPK" për aktivitetin: "Pastrimi i shkollave fillore 'Gjergj Fishta', 'Ismajl Qemali', 'Asim Vokshi', 'Dardania', 'Naim Frasheri', 'Pjeter Bogdani', 'Shkola e Gjelbert' dhe 'Mehmet Xhevorit' dhe me numër të prokurimit: 616-19-3237-211 nxjerr:

VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Laguna SHPK" e datës 23.12.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Pastrimi i shkollave fillore 'Gjergj Fishta', 'Ismajl Qemali', 'Asim Vokshi', 'Dardania', 'Naim Frasheri', 'Pjeter Bogdani', 'Shkola e Gjelbert' dhe 'Mehmet Xhevorit' dhe me numër të prokurimit: 616-19-3237-211, kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 19.12.2019*, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. **Vërtetohet** *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 19.12.2019*;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Laguna SHPK" me datë 23.12.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Pastrimi i shkollave fillore 'Gjergj Fishta', 'Ismajl Qemali', 'Asim Vokshi', 'Dardania', 'Naim Frasheri', 'Pjeter Bogdani', 'Shkola e Gjelbert' dhe 'Mehmet Xhevorit' dhe me numër të prokurimit: 616-19-3237-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 27.12.2019 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet se ju e plotësoni kërkesën për paga është i pa qendrueshëm, pasi që nuk është i bazuar në dispozitat ligjore që e rregullojnë këto çështje. Ua sqarojmë se në sipas rekomandimeve të Vendimit të OSHP-se kemi kërkuar interpretim lidhur me këto nga Administrata Tatimore dhe në bazë të të njëjtit kemi kalkuluar pagat dhe kemi vlerësuar se cili

nga tenderuesit e ploteson kete kerkese.Ne baze te interpretimit te ATK-se dhe dispozitave ligjore ne te cilat eshte thirrur i njejt jane kalkuluar pagat si vijon:

Pagat baze 282.50×83 punetor= $23.447.50$ €,te cilet duhet ti shtohet pervoja e punes prej $1,390.00$ euro e qe jep pagat mujore prej $24,837.50$ euro(Kjo eshte shtuar bazuar ne nenin 9.1.2 te Ligjit nr.05/L-028).Bazuar ne nenin 6.1 dhe 6.2 te Ligjit nr.04/L-101 ne kete vlere duhet te shtohet kontributi pensional prej 5% e qe eshte $24,837.50 \times 5\% = 1,241.87$ dhe kjo na jep vleren totale te pagave mujore prej $26,079.37$,e cila per 36 muaj eshte $26,079.37 \times 36 = 938,857.32$ euro.Kur kesaj i shtohet TVSH-ja prej 18% rrjedh si vijon: $938,857.32 \text{ €} + 18\% = 938,857.32 + 168,994.31 = 1.107,851.60$ euro.Nga kjo rrjedh se ky eshte çmimi total vetem per paga dhe TVSH pa llogaritur fitim te tenderuesit,qe d.t.th.se çmimi i dhene ne tenderin tuaj nuk e mbulon vetem kerkesen per paga dhe TVSH.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Shtese:Kerkesa dhe Interpetimet e ATK-se.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit